VENDIM
Nr. 754, datë 12.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 15.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 6, shkronjat "a", "b", "d", "e", e 7, pika 1, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, dhe të neneve 17 e 18, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 419, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Pagesa e subvencionit të bëhet 50% me miratimin e projektit dhe 50% në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën totale të projektit.".

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë zbatohet për periudhën tre vjeçare 2013, 2014 dhe 2015. Për vitin 2013 ai ka vlerën prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për vitin 2014 vlera e fondit do të jetë 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë dhe për vitin 2015 vlera do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë.".

2. Fondi prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, që do të shtohet për vitin 2014, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/AIDA-n, për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama